



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2022:273751

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05521215

C.nr.814/22

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË, Divizioni Civil, me gjyqtarin Nehat Qelaj, si dhe me bashkëpunëtoren profesionale Hajrije Krasniqi, në çështjen juridike të paditëseve D.M.dhe D. P. të punësuar në SHFMU “I. M.” në M., të cilët me autorizim i përfaqëson Av. Zahir Hamza nga Prishtina, ndaj të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson avokati publik komunal Mujë Sahitaj, sipas bazës juridike kompensim i shujtave, vlera e kontestit 708.00 euro, jashtë seancës gjyqësore me datë 28.03.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M
PËR SHKAK TË PADËGJUSHMËRISË

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve D.M.dhe D. P. të punësuar në SHFMU “I. M.” në M.,

II. DETYROHET e paditura Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit. që në emër të kompensimit të shujtave për ditët në punë, t’ua paguaj paditëseve në vijim: Paditëses **D.M.**, për 170 ditë të punës për periudhën 2021-2022 të përlllogaritur sipas shumës nga 2 euro në ditë t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej në **370.00 euro**, Paditëses **D. P.** për 184 ditë të punës për periudhën 2021-2022 të përlllogaritur sipas shumës nga 2 euro në ditë t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej në **368.00 euro**, të gjitha me kamatë ligjore prej 8% që nga dita e paraqitjes së padisë dt. 11.10.2022, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

III. DETYROHET e paditura që paditësve pjesërisht t’ua kompensojë shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të parashtrimit të padisë në shumën prej 156.00 dhe në emër të taksës shumën prej 20.00 euro, ndërsa **REFUZOHET** pjesa tjetër e shpenzimeve të paditësit në emër të parashtrimit të padisë shumën prej 52 euro (shuma prej vlerës së aprovuar 156.00 euro deri te vlera e kërkuar 208.00 euro) dhe në emër të shpenzimeve për përfaqësim në seancë shumën prej 202.80 euro.

A r s y e t i m

Paditëset D.M.dhe D. P. të punësuar në SHFMU “I. M.” në M., përmes të autorizuarit të tyre Av. Zahir Hamza nga Prishtina në këtë gjykatë kanë parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit, sipas bazës juridike kompensim i shujtave, sipas padisë paditësit janë të punësuar tek e paditura në bazë të kontratës së punës në vendin e punës në SHFMU “I. M.” në Malishevë paditëset e sipërhënuara i plotësojnë kushtet e përfitimit të shujtës ditore sipas kushteve të parapara më Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, për çka pretendojmë se i takon kompensimi i ushqimit në punë- shujtave ditore, gjykatës i ka propozuar që të aprovet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve, duke detyruar të paditurën që paditësve në emër të kompensimit në punë-shujtave ditore t’ua paguaj shumën paditëseve si në vijim: paditëses D.M.për 170 ditë pune të realizuara shumën prej 340.00 euro dhe paditëses D. P. për 184 ditë pune të realizuara shumën prej 368.00 euro, për të dy paditësit shumën në total prej 708.00 euro nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare dhe atë me kamatë prej 8%, në emër të shpenzimeve ka kërkuar sipas tarifës së odës së avokatëve, të precizuara në petitem të padisë, dhe atë për parashtrimin e padisë t’ia paguaj shumën prej 208.00 euro, për taksë shumën prej 20 euro dhe në emër të seancave shumën prej 202.80 euro

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditësve e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi e pranuar me datë 18.08.2023 mirëpo nuk ka parashtruar përgjigje në padi.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata i shqyrtoi këto provave dhe atë: për paditësen D. M., Vërtetimin mbi përvojën e punës nr.3190/22 dt.13.09.2022 dhe për paditësen D. P., Vërtetimin mbi përvojën e punës nr.3190/22 dt.13.09.2022, të lëshuar nga SHFMU “I. M.” në Malishevë.

Pas vlerësimit të të gjitha provave veç dhe veç dhe në lidhmëni me njëra tjetrën, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe si të tillë e aprovoj në tërësi.

Në bazë të provave të sipërpërmendura gjykata vlerëson se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura si mësimdhënës në SHFMU “I. M.”, por të njëjtëve nuk i janë kompensuar për periudhën si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, andaj nga provat e administruara, si dhe konform dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe datës 20.01.2021 të lidhur në mes Ministrisë së Arsimit Shkencë dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe SBASHK lidhur me kompensimin në emër të shpenzimeve të udhëtimit sipas nenit 35 par.7 në të cilën përcaktohet se **“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore, punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim”** kjo gjykatë vlerëson se paditëseve i takon e drejta e kompensimit për shujtë ditore gjatë punës për ditët e pranisë në punë përkatësisht për periudhën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sipas nenit 8 parag.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve **“Pjesëmarrësit në raportet e detyrimeve janë të detyruar që ti përmbushin detyrimet e tyre dhe janë përgjegjës për**

përmbushjen e tyre” ndërsa në dispozitat e nenit 245 par.1 të LMD-së, ka paraparë se *“Kreditore në marrëveshjet detyrimeve është i autorizuar që nga debitori të kërkoj përmbushjen e detyrimit e debitori është i detyruar ta përmbush me ndërgjegje këtë në tërësi ashtu si është e paraparë”*, meqenëse në rastin konkret është vërtetuar se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura lidhur me kërkesën për kompensimin në emër të shujtës ditore u vendos që të njëjtën t’ua aprovojë sipas periudhës të vitit 2021-2022 gjatë të cilës paditësit kanë punuar tek e paditura fakt ky që u vërtetuan edhe nga vërtetimet e lartcekura, në këtë gjendje të vërtetuar faktike e detyroj të paditurën që paditësve t’ua paguaj shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në kuptim të nenit 394, 395 al.1 dhe 2 të Ligjit të procedurës Kontestimore i ka dërguar të paditurit padinë, provat materiale dhe aktvendimin për dhënien e përgjigjes në padi.

Duke e bërë shikimin në fletë dërgesë për dorëzimin personal konstatohet se me datë 18.08.2023, i padituri-avokati publik personalisht i ka marr aktvendimin për përgjigje në padi i datës 31.07.2023, së bashku me padinë dhe provat materiale, mirëpo edhe pse ka kaluar afati i paraparë për dhënien e përgjigjes në padi, i njëjti nuk e ka parashtruar përgjigjen në padi, andaj duke u bazuar në dispozita ligjore të nenit 150 al.1 pika (a),(b) dhe (c), të LPK-së të lartë cituar, Gjykata mori Aktgjykim për shkak të pa dëgjueshmërisë (mosbindjes) ndonëse janë plotësuar kushtet si më poshtë vijojnë:

- a) Të paditurit i është dorëzuar në mënyrë të rregull padia, provat materiale dhe thirrja- Aktvendimi për dhënien e përgjigjes në padi,
- b) Themelësia e kërkesë padisë rezulton nga faktet e treguar në padi, dhe
- c) Faktet mbi të cilat mbështet kërkesë-padia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi.

Lidhur me kërkesën për kamatë, Gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 382 par.1 dhe 2 të LMD-së.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori konform nenit 453.1 të LPK-së, në të cilën përcaktohet se *“Me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do t’i shpërblehen palës, gjykata do të marrë parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumën e shpenzimeve, vendos gjykata duke çmuar me kujdes të gjitha rrethanat”* dhe Rregullores për tarifat e Avokatëve, ashtu që vendosi që paditësve t’ua njoh shpenzimet e procedurës duke detyruar të paditurën që paditësve t’ia paguajë shumën prej 156.00 euro në emër të parashtrimit të padisë shumën prej 21.00 euro në emër të taksës gjyqësore, ndërsa gjykata i **refuzoi** mjetet e kërkuara në emër të parashtrimit të padisë shumën prej 52 euro (shuma prej vlerës së aprovuar 156.00 euro deri te vlera e kërkuar 208.00 euro) për faktin se shuma e kërkuar nuk është në proporcion me vlerat e caktuara sipas Rregullores së Odës së Avokatëve për Tarifat e Avokatëve dhe në emër të shpenzimeve për seanca gjyqësore në shumën prej 202.80 euro, për faktin e nxjerrjes së këtij aktgjykimi për shkak të mosbindjes.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi komform nenit 150 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C nr.814/22 datë 28.03.2024

Gj y q t a r i
Nehat Qelaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 dite pas marrjes së të njëjtit, gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmjet të kësaj gjykate.